



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 47/2016

Prishtinë, më 16.02.2016, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-1

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa - kryetar, Sasha Milosavljeviq, Raif Qela, Sala Berisha-Shala, Blerim Grainca dhe Duda Balje, anëtarë.

Munguan: Visar Ymeri, Besim Beqaj, Fatmir Rexhepi, Pal Lekaj dhe Enver Hoti, anëtarë.

Pjesëmarrës të ftuar: Blerand Stavileci, ministër i Zhvillimit Ekonomik.

Pjesëmarrës të tjerë: Sabit Gashi, Alban Çollaku, Nezir Myrtaj dhe Skender Xani – MZHE; Fjolla Uka dhe Kaltrina Ahmeti – KDI; Dardan Abazi dhe Visar Berisha – INDEP; Lekë Batalli – GLPS dhe Artë Myftari – ZPRK.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 2-9.02.2016;
3. Votimi i raportit me amendamente i Projektligjit nr. 05/L-064 për Patentë shofer;
4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit Nr.05/L-081 për Energjinë;
5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit Nr.05/L-082 për Gazin Natyror;
6. Shqyrtimi në parim i Projektligjit Nr.05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë;
7. Shqyrtimi në parim i Projektligjit Nr.05/L-085 për Energjinë Elektrike;
8. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Miratimi i rendit të ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 2-9.02.2016.

Deputeti Raif Qela, duke iu referuar tekstit të procesverbalit, lidhur me amendamentin 24, tha se le të kuptohet sikur unë kam thënë, po pajtohem se zyrtarët që e mbajnë provimin profesional për instruktore të shoferëve, kemi vendosur që të jenë zyrtarë të emëruar nga ministri, qoftë nëpunësit brenda ministrisë apo ekspertë të jashtëm. Ai tha se për këtë çështje kam thënë që jam i bindur që po të dalë jashtë institucioneve, do të jetë më problem të kontrollohet.

Procesverbali i mbledhjes së datës 2-9.02.2016, u miratua me korrigjimin e propozuar nga z. Raif Qela.

3. Votimi i raportit me amendamente i Projektligjit nr. 05/L-064 për Patentë shofer

Kryetari tha se e keni marrë tekstin e spastruar dhe kemi kërkuar që secili që ka vërejtje dhe sugjerime të paraqitet, askush nuk është paraqitur. Unë i kam parë propozimet e deputetit Raif Qela dhe ato kanë një rregullim më të mirë.

Raif Qela tha se janë disa prej amendamenteve të cilat pas miratimit është dashtë të harmonizohen në disa prej neneve, tri apo katër neneve.

Komisioni, njëzëri, nxori këtë

Përfundim

1. Miratohet Raporti me Amendamentet e Projektligjit nr. 05/L-064 për Patentë shofer;

2. Raporti t'i procedohet Komisioneve të përhershme dhe Kuvendit, sipas procedurës.

4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit Nr.05/L-081 për Energjinë

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa, tha se meqenëse sot kemi në mbledhje ministrin e Zhvillimit Ekonomik, z. Blerand Stavilecin, për të prezantuar projektligjet e pakos së energjisë, atëherë do të vazhdojmë me shqyrtimin e projektligjeve në tërësi të fushës së energjisë. Kryetari Mustafa shprehi kënaqësinë për ardhjen e projektligjeve të energjisë të cilat janë të domosdoshme dhe obligim nga Komuniteti Evropian i Energjisë për zbatimin e pakos së tretë të legjislacionit të BE-së. Kryetari Mustafa ia dha fjalën ministrit Stavileci për të prezantuar projektligjet.

Blerand Stavileci, ministër i Zhvillimit Ekonomik, paraqiti Pakon e Projektligjeve të Energjisë, ku përfshihen Projektligji për Energjinë, Projektligji për Energjinë Elektrike, Projektligji për Rregullatorin e Energjisë dhe Projektligji për Gazin Natyror. Nisma për

rishikimin e legjislacionit të sektorit të energjisë buron nga detyrimet ndërkombëtare të Kosovës nga Marrëveshja për Themelimin e Komunitetit të Energjisë, përkatësisht Vendimit të Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë, e të cilat përcaktojnë detyrimet e Palëve Kontraktuale të Komunitetit të Energjisë për harmonizimin e legjislacionit të sektorit të energjisë me Pakon e Tretë të legjislacionit të BE-së për fushën e energjisë, theksoi z. Stavileci. Përgatitja e legjislacionit, sipas Pakos së Tretë, ka filluar në vitin 2013 dhe në këtë proces ka pasur një konsultim intensiv me Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, si dhe me përfaqësuesit e të gjitha palëve të interesit, ekspertët brenda sektorit të energjisë si: KOSTT, ZRRE, KEDS, KEK, potencoi ministri Stavileci. Ai më tutje sqaroi se kërkesat themelore të legjislacionit të Pakos së Tretë të BE-së, kanë të bëjnë me krijimin e kushteve ligjore dhe infrastrukturore që duhet të krijojnë Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë, në mënyrë që të bëhet i mundshëm funksionimi i tregut të përbashkët të energjisë në regionin e Palëve Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë. Si kërkesa thelbësore të Pakos së Tretë të legjislacionit evropian për fushën e energjisë, z. Stavileci sqaroi se janë ato sipas të cilave nuk lejohet që operatorët e sistemeve të transmisionit të jenë të ndërruar me asnjë formë nga aktivitetet e furnizimit dhe prodhimit, prandaj për këtë arsye duhet të bëhet certifikimi i tyre nga Autoriteti Rregullator i Tregut të Energjisë, ndërkohë që Sekretariati i Komunitetit të Energjisë do të ketë rol konsultimi para vendimit përfundimtar. Po ashtu edhe kriteret për vendosjen e obligimit të shërbimit publik do të jenë shumë më rigorozë dhe të përcaktuara qartësisht, ku po ashtu do të ketë rol konsultativ Sekretariati i Komunitetit të Energjisë me qëllim të sigurimit të mosdiskriminimit të ndërmarrjeve që veprojnë brenda tregut të përbashkët rajonal, ku përfshihen Palët Kontraktuese të Komunitetit të energjisë, potencoi z.Stavileci. Kërkesa themelore gjithashtu janë heqja e barrierave të licencimit, me parimin e reciprocitetit, për ndërmarrjet e licencuara në një Palë Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë, si dhe forcimi i rolit të Autoritetit Rregullues të sektorit të energjisë sqaroi ministri Stavileci. Me këtë rast dua të ritheksoj para deputetëve se duke marrë parasysh rëndësinë e materies që ka kjo pako e Projektligjeve të Energjisë për krijimin e kushteve ligjore dhe infrastrukturore të vendit tonë, si palë Kontraktuese e Komunitetit të Energjisë, me qëllim të funksionimit të një tregu të përbashkët të energjisë në rajon, tha në fund z.Stavileci.

Deputeti Raif Qela tha se kjo pako ligjesh synon të rregullojë një fushë shumë të rëndësishme të jetës. Këto ligje, aq sa shihet, janë disa prej detyrimeve tona ndaj Komunitetit Evropian të Energjisë, theksoi z. Qela. Ai në vazhdim tha se në faza të caktuara mund të kemi probleme mjaft të mëdha. Roli i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë është përcaktuar sikurse ai i Komisionit Evropian për direktivat Evropiane dhe atë në disa çështje: Certifikimi i operatorit sistemit nuk mund të mbyllet si proces pa e konstatuar edhe Sekretariati i Komunitetit të Energjisë se a është në rregull, kjo është në projektligjin për Rregullatorin e Energjisë; Nuk mund të vendosen obligime të shërbimit publik për ndërmarrjet e energjisë pa pasur edhe një mendim të Sekretariatit, dhe kjo te rasti ynë reflektohet në detyrimet e gjeneratorëve në rast të mungesave të furnizimit për të shitur energji në kushtet e rregulluara, kjo është në ligjin për energjinë elektrike dhe ligjin për gazin natyror. Bashkëpunimi rajonal me palët kontraktuale të komunitetit të energjisë është precizuar më qartë duke vendosur dispozita në ligjin për energjinë elektrike që duke ndjekur parimin e reciprocitetit ndërmarrjet e licencuara të një pale kontraktuese të komunitetit të energjisë nuk obligohen të licencohen edhe në Kosovë, kjo do të reflektohet edhe në atë sepse palët e licencuara në vendet fqinje do të licencohen me automatizëm sipas kësaj, sepse as nuk mund të parandalohen pasi që direktivat kërkojnë të

krijohet tregu i lirë potençoi z. Qela. Më tutje deputeti Qela theksoi se prodhuesit e energjisë nuk lejohet të shesin energji me tarifat e rregulluara nga ZRRE-ja, pra gjeneratorët e shesin energjinë me kontrata për shitjen e energjisë pa pasur asnjë rol ZRRE-ja dhe kjo paraqet sfidë për kontrollin e prodhuesit të ri “Kosova e re”, sepse furnizuesit e blejnë energjinë me kushte tregu dhe shteti nuk duhet të interferojë. Lidhur me këtë z. Qela pyeti ministrin se si do të rregullohet kjo në raport me kontratën që është bërë për “Kosovën e re”, sepse tarifat nuk do të rregullohen sipas ZRRE-së, por sipas tregut të lirë?

Kryetari Muhamet Mustafa e falënderoi z. Stavileci, për paraqitjen e ekspozesë së pakos së Projektligjeve që kanë të bëjnë për Energjinë, për Gazin Natyror, për Rregullatorin e Energjisë dhe për Energjinë Elektrike. Tha që këto Projektligje janë të një rendësi të veçantë pas që kanë të bëjnë me rregullimin e një fushë që mundëson zhvillimin ekonomik. Po ashtu theksoi se këto Projektligje që kanë ardhur nga Qeveria në pako për të u miratuar në Kuvend, janë sjellë në këtë formë, sepse kanë të bëjnë edhe me harmonizimin e direktivave të Bashkimit Evropian edhe me kërkesë të Sekretariatit të Komunitetit të Energji, prandaj ne, si Komision, deri në leximin e dytë do t’i shqyrtojmë dhe analizojmë të gjitha kërkesat që janë edhe nga palët e interesuara në mënyrë që të e rregullojmë këtë sektor. Lidhur për Projektligjin për Energjinë Elektrike, që parasheh që transmetuesi i rrjetit të jetë pronar që në këtë rast është KOSTT-i, kërkoi sqarime për këtë çështje pasi që për këto asete shteti duhet të jetë pronari? Për Operatorin i tregut çka është i rregulluar, dhe si do të korrespondojë me furnizuesin e tregut? Për Rregullatorin e Energjisë të çështja Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, lidhur me zgjedhjen e bordit, tha që zgjedhje e bordit, duhet të rregullohet që mënyra e votimi për zgjedhjen e anëtarëve të bordit në Kuvend të mos jetë në pako, por votimi të jetë veç e veç për secilin kandidat, pas më Ligjin në fuqi për Rregullatorin e Energjisë, koj formë e votimit ka qenë deri më tani që votimi të jetë në pako për gjithë kandidatët bordit, dhe rregullimi i votimit në Projektligjin për Rregullatorin e Energjisë, për votimin e çdo kandidati veç e veç, do t’u jap hapësirë deputeteve që të votojnë kandidatë më kredibil në menaxhim dhe profesionistë të kësaj fushe.

Deputeti Blerim Grainca përgëzoi ministrin për gjithë këtë punë për sjelljen e këtyre ligjeve për ta rregulluar njëherë e përgjithmonë këtë fushë. Këto ligje rregullojnë edhe furnizimin me energji i cili ndikon direkt në jetën e qytetarëve tanë dhe në fushën e investimeve theksoi z. Grainca. Ai propozoi që për këtë pako projektligjesh të bëhen një apo dy grupe punuese të cilat do të shqyrtojnë projektligjet një nga një dhe të vijnë me propozim amendamente për ndryshime të mundshme në Komision. Deputeti Grainca duke iu referuar nenit 14 të projektligjit për Rregullatorin e energjisë, pyeti lidhur me çështjen rregullimit të bashkëpunimit ndërkufitar se a rregullohet me automatizën si pjesë e të qenurit anëtar i Komunitetit apo ne duhet që në mënyrë individuale me vendet përreth të bëjmë marrëveshje bilaterale. Ai po ashtu pyeti se pajisja me certifikatën e energjisë prej 1Më a është në harmoni me ligjin që rregullon kapacitetet prodhuese, sepse dikush mund të ketë edhe kapacitete prodhuese më shumë se 1Më në fushën e energjisë së ripërtitshme, a lejohet me automatizëm me certifikatën që ka apo duhet që për çdo 1Më të pajiset me certifikatë tjetër.

Blerand Stavileci, ministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (MZHE), iu përgjigj pyetjeve dhe që u parashtruan nga ana e anëtarëve të komisionit. Ai tha që me miratimin e pakos së projektligjeve për energjinë ne, si shtet, po marrim obligime për këtë fushë, sepse duhet të e kemi rregullimin ndërkombëtar, i kemi 7 marrëveshje që duhet të bëjmë harmonizimi më

Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë dhe kemi marrë obligime që për këto marrëveshje të kemi licenca. Për çështjen e transmetuesit, tha që këto jemi konsultuar më Sekretariatit e komitetit të energjisë se si të e rregullojmë sektorin e transmetuesit të rrjetit elektrik. Për çështjen e bordit të ZRRE-së tha që këto kompetenca janë të Kuvendit, pas që vetëm propozim është i qeverisë, dhe zgjedhje anëtareve të bordit bëhet në Kuvend. Për tarifën, tha se këto janë 8 kërkesa që kemi listuar, tani ZRRE-ja ka treguar gatishmëri që disa prej tyre mund t'i trajtojë për atë sa lejon Ligji për Rregulltarin Energjisë. Për rast social tha, që kjo çështje është rregulluar nga ana e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Social. Për rregullimin e çështjeve të rrjetit elektrike ndërkufitar, tha që për këto çështje i kemi marrëveshjet ndërshtetërore, ku rregullohet sektori i balancimit primar dhe sekondar. Për burimet ripërtëritshme, tha që i kemi planet dhe projektet cakun ku do të arrijmë, po në këto sektor po hasim në problem, lidhur me licencat që janë më kohëzgjatje të shkurtër. Për operatorin e tregut, tha që për këtë rregullim është ndërmarrja "KOSTT" që bënë mbikëqyrjen e operatorit të tregut në aspektin e rregullimit teknik, ndërsa ZRRE-ja e bënë mbikëqyrjen në aspektin komercial. Z. Stavileci, theksoi se tani Kosova ka vetëm treg bilateral.

Pas debatit Komisioni, njëzëri, nxori këtë

Përfundim

1. Miratohet në parim Projektligji Nr.05/L-081 për Energjinë;

2. I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim Projektligjin nr.05/L-081 për Energjinë.

Komisioni vendosi që Grupi i punës për shqyrtimin e këtij projektligji, të jetë më këtë, përbërje: Raif Qela, kryesues, Sasha Milosavljeviq, Sala Berisha - Shala dhe Fatmir Rexhepi, anëtarë;

5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit Nr.05/L-082 për Gazin Natyror

Kryetari tha se për këtë pikë të rendit të ditës debati u zhvillua në pikën e katërt.

Komisioni, njëzëri, nxori këtë

Përfundim

1. Miratohet në parim Projektligjit nr.05/L-082 për Gazin Natyror.

2. I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim Projektligjin nr.05/L-082 për Gazin Natyror.

Komisioni vendosi që Grupi i punës për shqyrtimin e këtij projektligji, të jetë me këtë, përbërje: Besim Beqaj, kryesues, Blerim Grainca dhe Duda Balje, anëtarë.

6. Shqyrtimi në parim i Projektligjit Nr.05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë

Kryetari tha se edhe për këtë pikë të rendit të ditës gjithashtu debati u zhvillua në kuadër të pikës së katërt.

Komisioni, njëzëri, nxori këtë

Përfundim

1. Miratohet në parim Projektligji nr.05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë.

2. I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim Projektligji nr.05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë.

Komisioni vendosi që Grupi i punës për shqyrtimin e këtij projektligji, të jetë me këtë përbërje: Raif Qela, kryesues, Sasha Milosavljeviq, Sala Berisha - Shala dhe Fatmir Rexhepi, anëtarë.

7. Shqyrtimi në parim i Projektligjit Nr.05/L-085 për Energjinë Elektrike

Kryetari tha se ky është projektligji i fundit për të cilin edhe debati u zhvillua në kuadër të pikës së katërt.

Komisioni, njëzëri, nxori këtë

Përfundim

1. Miratohet në parim Projektligji nr.05/L-085 për Energjinë Elektrike.

2. I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim Projektligji Nr.05/L-085 për Energjinë Elektrike.

Komisioni vendosi që Grupi i punës për shqyrtimin e këtij projektligji, të jetë me këtë, përbërje: Besim Beqaj, kryesues, Blerim Grainca dhe Duda Balje, anëtarë.

8. Të ndryshme Çështje vijuese

Deputetja Sala Berisha-Shala i njoftoi deputetët se sot ishte një tryezë ku një kompani për hulumtime në sektorin minerar pati një prezantim lidhur me hulumtimet në sektorin minerar. Kjo kompani planifikon investime të mëdha dhe do të ishte mirë t'i ftojme edhe në Komision që ta prezantojnë planin e tyre. Kërkova prej të pranishmëve që të gjitha pengesat apo barrierat eventuale në legjislacion t'i identifikojnë dhe t'i qasemi në mënyrë të drejtë zgjidhjes së problemeve legjislative.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa